e të sëmurit. Martesa një grua që ka të shoqin gjall ose me një grua që s'është e gjallë: del hajir, po dasma me çalgi nuk del mirë. Ne ëndër kush bën xhima me grua (d.m.th. afrim shpëton nga hidhërimi! Kush i bën xhimà armikut: armikun e mposht. E bëra afrim me një grua të ligë: s'del mirë. Po e bëra afrim me një kafshë; del hajir.

(ZOTI mëshirë plot e di më mirë).

Kush sheh mbret, mëmë, at, evlat, persona tregëtarë e çdo lloj mjeshtra, ëndra ç' kallzon?

Kush sheh mbretin të gëzuar; ka naltësi edhe hajir. E para të helmuarë: s'është mirë. E fjalosura me mëmën: janë lajme të mira. Duke se është e vdekur po të shohish mëmën që vdes në xhenet kà pjesë. Kush sheh mëmën a babën të gëzuar: del i trashëguar. Evlati: shënon niqah edhe fitim. Të pamit pleq është ndërim. Të pamit grua; është dynja. Vajza e mirë: pasuni, e shëmtuara: varfëri, foshnja e sisës: gëzim. Çun i shemtuar: hidhërim, çun i spastruar: shpëtim nga mundimi. Të pamit atë grua që s'është Mysliman shënon mall me haram. Të pamit pafesi është prapësi. Të pamit njerës të liq: vjen nga punimet e liga.

* * *

Kush sheh punëtor: gëzimi i jep dorë. Gjatori: shënon atë person që shtihet pas gravet. Kapedan i vaporit dhe shoferi: shpëtim. Inxhineri: ndërtim. Mësonjsi dhe shkronjsi: dituri edhe fat. Shtypëshkronja: përparim dhe jetë të gjatë.

* * *

Barnatari (exhsaxhiu): màll dhe paqë. Kujunxhiu: pasuni. Furxhiu; martesë. Gjellbërsi: gëzim, hallvaxhiu: niqah dhe evlat; sheqerxhiu: dituri, hambarxhiu: bereqet; bardhakçiu: zyrrijet; ngjyraxhiu: gëzim; sazexhiu, qymyrxhiu, qerestexhiu: hidhërim. Synetxhiu, hamamxhi: spastrim. Teneqexhiu: gënjeshtar. Kallanxhiu shënon punim të kulluar. Bariu: nënëpunës. Qiraxhiu: shendet. Kretari: fuqi. Tregëtari: naltësi. Aktari: gëzim. Druvari, kashtari: lirësi. Lipsari: dituri. Kusari: sëmundje. Berberi: shënon një afrim ke mbreti. Xhambazı: përparim. Hamalli: mundim. Kasap i pastër: shënon fat edhe jetë të gjatë. (Po ca kasapin e thonë: melaiqe i vdekjes). Saraçi, nalbani: niqah edhe udhëtim. Kovaçi: forcim. Jevga: hidhrim. Trimi: gëzim.

* * *

Kur sheh kafshëri, shpeshëri, pishqëri, ëndra ç' kallzon?

Kush sheh kalë: ka ikball të mirë. E mara ose e hipura kal a pelë: shënon martesë. Bishti i kalit po të shihet i prerë: s' është mirë, po të shihet i gjatë: vjen ndihmë. Kal i zi: shënon grua me keq vetij. I bardhi: grua me mirveti, e shitura kalë: keq udhëtim. Kali çal: shtrëngim. E fërkuara kalin: dashuri. Gomar i dobët: varfëri. I ngjallmi: pasuni. Gomar i ngarkuar: naltësi. Kau, ndreja: del hajir. I sëmuri a i burgosuri po të shohë kà: